



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCEVE

Ministrja Vukaj takohet me Përfaqësuesin e FMN Reinke.

2017-06-02 11:01:00



Ministrja e Financave znj. Helga Vukaj zhvilloi më datë 2 qershor 2017, një takim me Përfaqësuesin Rezident të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Shqipërinë z. Jens Reinke.

Në qendër të këtij takimi ishte stabiliteti ekonomik dhe monitorimi i të ardhurave.

Znj. Vukaj theksoi se në garantim të interesit publik, Ministria e Financave kryen monitorim ditor të të ardhurave për të siguruar konformitetin e tyre me planin dhe për të garantuar që procesi zgjedhor nuk do të çënojë vazhdimësinë institucionale apo të ndikojë tek operatorët ekonomike.

Përfaqësuesi i FMN-së z. Reinke theksoi rëndësinë që ka realizimi i të ardhurave si dhe mos-shpërdorimi i fondeve publike.